



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



**KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS**

**Komiteti për Politikë dhe Financa**

**Nr. Protokolit: 060/01-84027**

**Data: 10.10.2024**

**Për: Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa – KPF**

**FTESË**

Të nderuar anëtar/e,

Ju ftojme që të merrni pjesë në mbledhjen e IX të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2024. Mbledhja do të mbahet me dt. 18.10.2024 (Premte), ora: 11:00, në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

*Vërejtje: Komiteti për Politikë dhe Financa mbanë të drejtën për ta aplikuar nenin 45. paragrafin 3. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nëse kjo gjë shihet e nevojshme.*

**RENDI I DITËS**

1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesat.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të KPF-së dt. 16.09.2024.
3. Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend për miratimin e normës tatimore për tatimin në pronë në Komunën e Pejës, për vitin 2025.
4. Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend për miratimin e propozimit për faljen e borxheve në taksa afariste për bizneset që kanë operuar dhe operojnë në Komunën e Pejës.
5. Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend i Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit.
6. Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend i raportit financiar të Komunës së Pejës për periudhën Korrik – Shtator 2024.
7. Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend i informatës për gjendjen ekonomiko-financiare në Komunën e Pejës.
8. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç jan pranuar. (Për tu dorëzuar të Sekretari jo më vonë se të Enjëte, me dt.17.10.2024).

**KRYESUESI I KPF-së**

**Recep Kurtbogaj**



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

Adresa: Rr. Hasan Prishtina

Tel: 03820043433



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



**SKUPŠTINA OPŠTINE PEĆ**

**KOMITET ZA POLITIKU I FINANSIJE**

**Br. Protokola: 060/01-84027**

**Datum: 10.10.2024**

**Za: Članove Komiteta za Politiku i Finansije-KPF**

**POZIV**

Poštovani članovi/članice, pozivamo vas da čestvujete na IX sednici Komiteta za Politiku i Finansije za 2024. Godinu, koja će biti održana 18.10.2024 (u petak) u Sali Komiteta za Politiku i Finansije.

*Napomena: Komitet za Politiku i Finansije zadržava pravo primene člana 45 stav 3 Zakona o Lokalnoj Samoupravi, ako se to smatra potrebnim.*

**DNEVNI RED**

1. Učešće i odsustvo članova na sednici.
2. Razmatranje i usvajanje zapisnika KPF-a od 16.09.2024.
3. Razmatranje i preporuka Skupštini za usvajanje poreske norme za porez na imovinu u Opštini Peć za 2025. Godinu.
4. Razmatranje i preporuka Skupštini za opraštanje duga za poslovne takse i biznise koji su radili i rade u Opštini Peć.
5. Razmatranje i preporuka Plana delovanja za primenu preporuka datih od Nacionalne kancelarije za Reviziju.
6. Razmatranje i Preporuka Skupštini Finansijskog Izveštaja Opštine Peć za period Juli-Septembar 2024.
7. Razmatranje i preporuka Skupštini informacija o ekonomsko-finansijskom stanju u Opštini Peć.
8. Pitanja i predlozi u vezi rada Opštine, istaknuti od članova, po redosledu po kome su primljeni. (Dostaviti Sekretaru ne kasnije od srede, 16.10.2024).

**PREDSEDAVAJUĆI SKUPŠTINE**  
**G-din Rexhep Kurtbogaj**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

---

## **KUVENDI KOMUNAL PEJË**

### **Komiteti për Politikë e Financa**

**I.Numër: 060/01-74404**

**Pejë, datë: 16 shtator 2024**

### **PROCESVERBAL**

Nga takimi i **VIII**- i Komitetit për Politikë e Financa i KK-së Pejë, mbajtur me **16 shtator 2024**, në orën 10:00.

Takimi u mbajt në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pos anëtarëve të komitetit, në këtë takim prezantojnë: Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, Drejtori i ÇPJ, z.Arianit Krasniqi, Drejtori i Sherbimeve Publike, z.Agron Nikçi, Zyrtarja Kryesore Financiare, znj.Hajrije Haxhijaj,Udhëheqës i Sektorit të Kuvendit, z. Avni Gashi, Zyrtare Administrative, znj. Donjeta Morina, Asistente e kryesuesit, znj.Florlinda Berisha, dhe përfaqësuesit e ZIP-it dhe OSBE.

Takimin e hapi dhe e udhëheqi, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, i cili hapi diskutimin për rendin e ditës, dhe i sqaroi të gjitha pikat të cilat janë vendosur në rend ditë dhe deklaroi se rendit të ditës j'u shtu edhe një pikë shtesë 12. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Sali (Shaban) Qelaj, me qëllim të përmbushjes së interesit publik.

Pas diskutimeve nga të gjithë anëtarët prezent u miratua ky rend dite, me 9 vota pro, kundër nuk ka, të përmbajtur nuk ka.

## Rendi i Ditës

1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të KPF-së dt. 16.07.2024.
3. Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Pejës 2025-2027.
4. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Fatmir Zymberi, me qëllim të përmbushjes së interesit publik.
5. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të znj. Ajmon Sefa, me qëllim të përmbushjes së interesit publik.
6. Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e propozimit të Drejtorisë së Administratës dhe Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e kryesuesve të Këshillave Lokale për vitin 2023 dhe 2024.
7. Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e propozimit të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Pejës për kompensimin e Komiteteve Konsultative për vitin 2023 dhe 2024.
8. Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e anëtarëve të KKSB-së për vitin 2023 dhe 2024.
9. Shqyrtimi dhe rekomandimi për dhënie në diskutim publik të Draft –Planit të Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, 2024-2026.
10. Shqyrtimi dhe rekomandimi për dhënie në diskutim publik të Draft Rregulloren për Sherbimin e Transportit me Marimangë në territorin e Komunës së Pejës.
11. Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës nga DKA për fillimin e vitit shkollor.
12. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Sali (Shaban) Qelaj, me qëllim të përmbushjes së interesit publik.
13. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar:

### **1.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.**

Nuk ka pasur.

### **2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KPF-së dt. 16.07.2024**

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent, miratohet procesverbali i KPF-së i dt.16.07.2024

### **3. Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Pejës 2025-2027.**

**Znj.Hajrije Haxhijaj:** planifikimi i buxhetit për vitin 2025-2027, siq ju kam cek edhe në fillim në qarrkoren buxhetore 2 qe neve na ka ardh me 14 gusht ministria i ka caktu kufijtë buxhetore për kategori ekonomike. Ku kemi pas disa levizje në të gjitha kategorit, në kategorinë paga dhe meditje i kemi 18,808,949.00euro. Unë, po i ceki vetem për vitin 2025 sespe keto dy vitet tjera i

keni të shenuara në material. Po ashtu ka ndryshuar edhe kategoria e mallrave dhe shërbime është 5,297,000.00 euro të cilën kemi pas një zvogëlim prej kornizes afatmesme buxhetore. Ndërsa shërbimet komunale e kanë një kufi prej 1,054,775.00 euro, edhe kjo e ka një zbritje të vogël, duke marr parasysh që kategoria e pagava dhe medijve ka pësuar rritje në qarkoren e 2 diku rreth 210 mijë euro. Kjo shumë është zbrit në kategoritë tjera ekonomike. Kategoria e subvencioneve ka mbetur 1,200,000.00 euro ashtu siq është e paraqitur në kornizen afatmesme buxhetore. Ndërsa kategoria e shpenzimeve kapitale është 13,481,658.00 euro. Këtu e kemi një material që e kemi shpërndarë ku paga dhe medijtje është në totale që është planifiku, ku është paraqitur edhe stafi për vitin 2025. Stafi ka pësuar një zvogëlim prej 3 zyrtarëve dhe kjo ka ndodhur tek rojet e pyjeve të parkut, kanë kaluar në Ministrinë e Planifikimit Hapsinor, dhe kemi bërë një zbritje prej 3 zyrtarëve ku edhe e ka specifikuar edhe ministria në qarkoren buxhetore 2.

**Znj.Kaltrina Lajqi:** sa janë marr parasysh kërkesat e qytetarëve në takim që është mbajtur muajin e kaluar për t'u fut buxhet?

**Znj.Hajrije Haxhijaj:** ne vetëm e kemi publikuar raportin e degjimeve buxhetore, dhe muaj mëson që afër 70% të kërkesave janë fut në buxhet për vitin 2025. Shumica e kërkesave kanë qenë për ndriqim, kanalizim dhe disa rrugë e shumica prej tyre kanë mbetur vetëm me specifikum ose me u detajuar!

**Z.Berat Ganiqi:** nuk bëjmë pyetje pa qenë prezent drejtoresha e financave.

Nga të gjithë anëtarët prezenti me 5 votë pro, 4 anëtar nuk marrin pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim buxheti i Komunës së Pejës 2025-2027.

#### **4.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Fatmir Zymberi, me qëllim të përmbushjes së interesit publik.**

**Z.Arianit Krasniqi:** ne kemi ardhur me propozim për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private të z.Zymberi, me qëllim të përmbushjes së interesit publik, me qëllim të rregullimit të pronës e cila ndodhet në hyrje/oborrin e shkollës fillore "Skender Qeku" në fshatin Qyshk. Pronari privat e ka të ndërtuar shtëpinë në oborrin e shkollës dhe përmes parcelës së tij hyhet në shkollë, dhe propozimi është me ndru me marr pjesën hyrjen e shkollës dhe atij i jepet pjesa tjetër që e ka të ndërtuar me vite shtëpinë.

**Z.Berat Ganiqi:** te këto këmbimet prap po vazhdon me avazin e njejt, hala nuk ka ardhur prej gjykatës se a ka ndonjë kontest gjyqësor dhe nuk ka asnjë dokument gjyqësor të bashkangjitur. Po ju tregoj një rast një këmbim të cilin e kemi anuluar të shpalljes të interesit në Raushiq. Unë, jam njoftuar që ai rast është në gjykatë duke u trajtuar, dhe tash është mbajtur seanca në fillim të shtatorit.Plus që këtij ma heret ja paska marr komuna apo kush nuk e dim në çfarë mënyre ja kanë marr, por a kemi kqyr a j'u ka kompenzuar në atë kohë? Sepse unë po ta tregoj përvojën prej ministrisë shpesh pronat që janë pagu, kanë mbetur edhe në emër të njerëzve. Dhe kur janë bo

këmbimet janë bo nga 2,3 here dhe janë pagu nga 2,3 here për atë këmbim. Prap po them në aspektin ligjor kur nuk po vin keto dokumenta dhe ai mundet me pas me drejte krejt se ka jetu aty, mirpo në aspektin ligjorë si lëndë nuk është e kompletuar.

**Z.Arianit Krasniqi:** ne hetues nuk jemi, ne e shohim nese nuk ka ndalese në kadaster, dhe vazhdojmë me procedurat e këmbimit!

**Z.Berat Ganiqi:** askush nuk po e thotë me luft rolin e hetuesit e as policisë, por së paku në gjykatë me kërk lëndën a është në gjykatë a ka ndonjë kontest për këtë parcelë. Dhe çështja e dytë është që brenda komunes me kërk që a është bë ndonjëhere shpronësimi!

**Z.Arianit Krasniqi:** ne e kemi kërk edhe historiatin e kesaj çështje mirpo nuk ka ndonjë lëvizje.

**Z.Labinot Panxha:** përveq ktyre që i tha kolegu unë e kom pa që ka shpërputhje dhe me aq sa e kam analizu keto dokumenta të kësaj dosje, prej marveshjes që e kanë bo është numri i ndryshem, prej fteses që ju ka bo kryetari drejtuar kuvendit dhe po ashtu numrat e parcelave nuk janë në përputhje me numrat që janë në hartografi etj. Po mendoj që ish dasht me i kqyr dhe me i analizu, pastaj me i sjellë këtu, sespe po supozojmë që e votojmë dhe krejt janë numrat në shperputhje me njëra-tjetren.

**Kryesusi Rexhep Kurtbogaj:** le te meret si obligim që të permisohen numrat nese janë gabim dhe deri në seancë të jetë në rregullë.

**Znj.Xhevahire Çeku Kelmendi:** unë j'u kisha bo thirrje me votu këtë pikë të rendit sepse shkolla “ Skender Çeku” e shfrytëzojnë 3 fshatra dhe ajo vërtet ka nevoj për hapsira. Po më vjen mirë që ka ardh si rend dite për me ndermar diqka për aty, sepse aty vijojnë mësim nxënësit e fshatrave Qyshk, Pavlan, dhe të Bllagajes, ata kanë nevoj për fusha sportive dhe hapsira. Ju kisha lut opozites me votu kete pike dhe piken vijuse.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 vota pro, 3 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, 1 votë e përmbajtur, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim propozimi i DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Fatmir Zymberi, me qëllim të përmbushjes së interesit publik.

**5.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të znj. Ajmon Sefa, me qëllim të përmbushjes së interesit publik.**

**Z.Arianit Krasniqi:** po bëhet fjalë për të njejten shkollë me realizu hyrjen, propozim këmbimi do të bëhet në mes Komunes Pejes dhe pronares private znj.Ajmon, ngastra kadastrale 91/19 me sipërfaqe 224 m<sup>2</sup> ZK. Qyshk është pronë komunale, propozohet të këmbehet me pronen e znj.Ajmon ngastra kadastrale 92/13 me sipërfaqe 290m<sup>2</sup> ZK.Qyshk me qëllim të përmbushjes së interesit publik.

Nga të gjithë anataret prezent me 5 votë pro, 3 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, 1 votë e përmbajtur i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim propozimi i DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të znj. Ajmon Sefa, me qëllim të përmbushjes së interesit publik

**6.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Sali (Shaban) Qelaj, me qëllim të përmbushjes së interesit publik.**

**Z.Arianit Krasniqi:** edhe kjo pothuajse e njejta kërkesë për këmbim bëhet fjalë për qarshin e gjatë aty e ka pronari privat pjesen ku futet nga mesi i pjeses ku frekuentohet nga këmbësorët dhe kjo është pronë komunale.Sipas planit ideor për qarshin e gjatë e kanë verifiku në urabnizem dhe e kanë jep pelqimin, e kanë pa që kjo parcelë mundet me u nda dhe me u bo kompenzimi meter për meter në keto dy pjesë. Prona komunale është me nr.ngastre 3394/8 me sipërfaqe 33 m2 ZK Pejë, dhe këmbëhet pronë private të pronarit z. Sali ngastra 936/2 33m2 ZK Pejë, kjo meret me qëllim të përmbushjes së interesit publik të formimit të rruges në Qarshin e Gjatë në Pejë. Në përputhje të plotë me planin ideor “Qarshia e Gjatë” sipas Instituti të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve.

**Z.Berat Ganiqi:** që sa është pronar z.Sali Qelaj të kësaj parcele?

**Z.Arianit Krasniqi:** është pronar në vitin 2024 se di saktë por materiali është ardh pak me vonesë sepse jemi shku me verifiku edhe në kadaster edhe në gjykatë.

**Z.Berat Ganiqi:** në 2024 po bëhet pronar, dhe në 2024 po i ofrohet këmbimi, qetu e kam hallin tash unë z.Sali Qelaj, është biznismen po më doket jeni lshu në biznise të rënda dhe nuk kam asgjë me shtu tjetër!

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 votë kundër, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim propozimii i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Sali (Shaban) Qelaj, me qëllim të përmbushjes së interesit publik.

**7.Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e propozimit të Drejtorisë se Administratës dhe Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e kryesuesve të Këshillave Lokale për vitin 2023 dhe 2024.**

**Kryesusi Rexhep Kurtbogaj:** kemi me marr një vendim për kompensimin e këshillave lokal për vitin 2023 dhe vitin 2024. Shuma që është parapa me u pagu, ata i kanë 6 takime obligative brenda vitit në vlerë 50 euro dhe ju bjen 300 euro për komplet vitin.

Unanimishtë të gjithë antaret prezent, i rekomandohet kuvendit për miratim propozimi i Drejtorisë se Administratës dhe Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e kryesuesve të Këshillave Lokale për vitin 2023 dhe 2024.

**8.Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e propozimit të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Pejës për kompensimin e Komiteteve Konsultative për vitin 2023 dhe 2024.**

**Kryesusi Rexhep Kurtbogaj:** edhe kjo pikë është për kompensimin e Komiteteve Konsultative për vitin 2023 dhe për vitin 2024.

Unanimishtë të gjithë antaret prezent, i rekomandohet kuvendit për miratim propozimi i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Pejës për kompensimin e Komiteteve Konsultative për vitin 2023 dhe 2024.

**9.Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e anëtareve të KKSB-së për vitin 2023 dhe 2024.**

**Kryesusi Rexhep Kurtbogaj:** edhe antaret e KKSB-së për vitin 2023 dhe 2024 nuk janë kompensuar për takimet që i kanë mbajt

**Z.Labinot Panxha:** këtu janë edhe komandanti i policisë, a paguhen edhe kta prej neve?

**Kryesusi Rexhep Kurtbogaj:** fjala është me u pagu të gjitha.

Unanimishtë të gjithë antaret prezent, i rekomandohet kuvendit për miratim propozimi i Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e anëtareve të KKSB-së për vitin 2023 dhe 2024.

**10.Shqyrtimi dhe rekomandimi për dhënie në diskutim publik të Draft –Planit të Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, 2024-2026.**

**Kryesusi Rexhep Kurtbogaj:** është një material që ka ardh nga drejtoria e arsimit, drejtorin nuk e kemi prezent por në seancë do të jet prezent !

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim dhënia në diskutim publik të Draft –Planit të Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, 2024-2026.

**11.Shqyrtimi dhe rekomandimi për dhënie në diskutim publik të Draft Rregulloren për Sherbimin e Transportit me Marimangë në territorin e Komunës së Pejës.**

**Z. Agron Nikqi:** kjo si procedurë ka shku gjithmonë përmes tenderit, përmes zyres së prokurimit në konsulltim me zyrtarët e USAID-it. Në disa komuna sipas ligjit kjo duhet me dal në ankand përmes kuvendit me shku në dëgjim publik të qytetarëve, pastaj me kalu në kuvend dhe me u shpallë në ankand. Kjo është një draft rregullore fillestare për sherbimin e transportit me marimangë në territorin e Komunës së Pejës. Kjo rregullore ka me qenë valide për Komunen e Pejës, janë parapa pak a shumë procedurat se qysh kanë me shku në terheqjen së veturave. Edhe



prej policisë kemi kërkesa që sa më shpejt të shpallet në ankand, të nxiret fituesi dhe të jetë aktive. Po ashtu sa i përket bllokadave të vetuave nuk do të jetë në ankand sepse po doket një sistem jo i përshtatshëm për qytetarët. Është një pikë që ka bo probleme gjatë gjithë kohës për komunën e Pejës, problemi i vendosjes së veturave që kanë mbetur me vite dhe dikur ata i kanë padit, komuna mer përgjegjësi 72 orë për veturën, mbasandej nuk mer përgjegjësi mer vet pronari i veturës ose operatori. Kjo ishte si përmbledhje dhe pas dëgjimit me qytetarët do të marim edhe rekomandimet e tjera ose ndryshimet dhe pastaj vazhdojmë me procedurat tjera që i parasheh ligji për ankand.

**Z.Berat Ganiqi:** meqenëse komuna ka mujt edhe me ndërmarje lokale me bo si pjesë të veten dhe taksat me i mar vet! Por problemi te operatorët është se shpesh here kanë edhe konflikt interesi sepse operatori nuk i qet vet, po në bashkëpunim me policinë. Unë jam kundër këtyre bllokadave sepse janë edhe anti-kushtetuese, se ma mire me ja marr veturën krejt e din ai që ska veturë, se sa me ja lon aty dhe me ja vendos bllokaden, sepse në rast fatkeqësie me ndodh në shtëpi ndonje rast me dergu në ambulancë ti je i bllokum para shtëpisë. Nuk jam për me i anestu shkelësit, por me pas qfar kriteri se më së pari nuk mundet me kon ndonjë policë që e fiton sepse dihet për qka po e fiton për interesa të veta. Duhet me dal disa kriterë që i menjanon policinë dhe zyrtarët e komunes që punojnë brenda në komunë. Në një rregullë aty e pash që edhe inspektorat komunal me rregullore e pash që kanë drejt me kërk, ata ndoshta kanë drejtë me kërk me ardh policia sespe me ligjin mbi trafik nuk kanë drejtë me bo largimin e veturave me kerku prej marimanges, sepse nuk është institucion që i shqipton gjobat në trafik. Kjo është brenga ime se nese ju premtori që heket bllokada ne edhe e votojmë.

**Z.Agron Nikqi:** ne po e kalojmë vetem për dëgjim publik, pastaj pas dëgjimit publik meren parasysh rekomandime dhe pastaj rregullorja finale.

**Z.Labinot Panxha:** është mire kjo me u sqaru sepse nuk ka drejt me ta blloku veturën askush madje as policia, ka drejt me ta tërheq veturën në vendet ku konsiderohet që e ke blloku rrugën por me ta blloku nuk ka drejt askush!. Ne mos ta bëjmë gabimin e njejt me u pedat neper gjykata duke e ditur që e kemi të njejtën rast në Prishtinë, pra të meren parasysh ato se qka u thanë sot se sigurisht na e votojmë për me qit në diktum publik dhe sigurisht edhe atje ka me pas vërjetje dhe sugjerimi. Mirpo unë mendoj që ish dasht me mar një analizë të mirë dhe pastaj me qit në funksionim, sepse nuk mundesh me thonë që keto qka i ki vendos në rregullore në ankand nuk i qet, sepse athere po del me kundërshtim me rregulloren që ti e ke nxjerrë. Sepse është e pamundshme me shpallë një ankand dhe me vendos ma shumë ose ma pak kriteret që e percakton rregullorja, se kushdo që fiton dhe është i pa knaqur mundet me ta pru atë kontest të çfarë do forme, kshuqë më mirë është mos me pas nese vlersohet se sa me pas e mos me vendos më vonë si kriter, se di a jam i qartë!

**Kryesusi Rexhep Kurtbogaj:** edhe unë jam i pajtimit me dy koleget e opozites që mos me qenë në funksion kjo puna e bllokades së vetures.

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent, i rekomandohet kuvendit për dhënie në diskutim publik të Draft Rregulloren për Sherbimin e Transportit me Marimangë në territorin e Komunës së Pejës

## **12.Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës nga DKA për fillimin e vitit shkollor.**

**Kryesusi Rexhep Kurtbogaj:** e kanë dergu një material si informat, mirpo drejtori nuk është prezent

**Z.Labinot Panxha:** unë e kam një propozim për ju kryesus të gjitha pikat që ti dergojnë për shqyrtim në KPF drejtoritë përkatëse, të cilat nuk marin pjesë pa arsytim mos me na sjellë dhe as mos me i vendos në rend dite. Sepse po mendoj që po bëhet një nënvlersim i ketij komiteti dhe nuk e meritojmë na si njerëz në pozita që jemi me u nënvlersu nga drejtorja të tillë, është e nevojshme me qenë drejtori ktu dhe me na njoftu për pikat .

**Kryesusi Rexhep Kurtbogaj:** muj me diskutu edhe ne bord me ekzekutivin sespe neve kur na bin konkluzionet me konfirmim të kryetarit na obligon me i vendos!

**Z.Labinot Panxha:** ju si kryesus bashke me neve ketu me mar vendim me vota, mos me i shqyrtu keto pika ketë te drejte e kemi!

Nga të gjithë anëtarët prezent me 4 votë pro, 2 votë kundër, 1 votë e përmbajtur, 2 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit me vërjetjet që u dhanë informatë nga DKA për fillimin e vitit shkollor

## **13.Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, ne atë rënditje siç janë pranuar:**

*Pjesë e këtij procesverbali është edhe audio incizimi i këtij takimi të Komitetit për Politikë dhe Financa.*

**Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime të tjera nuk pat, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të KPF-së në orën 12:05 h.**

**Procesmbajtësja,  
znj. Donjeta Morina**

---

**K R Y E S U E S I,  
z. Rexhep Kurtbogaj**

---





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Pejës / Opština Pec / Municipality of Peja

## DREJTORATI PËR BUXHET DHE FINANCA

Bazuar Ndryshimin dhe Plotësimin e të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.06/L-005, neni 9, pika 4. Kuvendi i Komunës cakton shkallën e aplikueshme tatimore për çdo kufi tatimor sipas paragrafit 3, deri me 30 nëntor të vitit para vitit të vendosjes së tatimit. Shkallët tatimore të përcaktuara nga komuna duhet të kenë trend progresiv dhe e cila dallon nga vitet e mëhershme kur kemi pas shkalle tatimore ne baze te kategorive te pronave, ne si ZTP ju propozojmë qe shkalla tatimore për vitin 2025 shkalla bazike

### PROPOZON

## CAKTIMIN E NORMAVE TATIMORE PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2025

### Neni 1

#### Shkalla tatimore progresive

1. Caktohen normat tatimore për vitin 2025 për të gjitha vlerat e pronave në territorin e Komunës së Pejës, sipas vlerës së kombinuar të gjitha pronave të paluajtshme të tatimpaguesit, si vijon:

- 1.1. Për vlerën e pronave deri në njëqindmijë (100,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.10 %**;
- 1.2. Për vlerën e pronave mbi njëqind mijë (100,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.20%**, plus tatimi nga nën-paragrafi 1.1 të këtij neni;
- 1.3. Për vlerën e pronave mbi pesë qind mijë (500,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.30 %**, plus tatimi nga nën-paragrafët 1.1 dhe 1.2 të këtij neni;
- 1.4. Për vlerën e pronave mbi një milion (1,000,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.40 %**, plus tatimi nga nën paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të këtij neni; dhe
- 1.5. Për vlerën e pronave mbi pesë milionë (5,000,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.50%**, plus tatimi nga nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të këtij neni.

2. Normat tatimore sipas këtij neni caktohen konform nenit 9 të plotësuar dhe ndryshuar me nenin 2 të Ligjit Nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

### Neni 2

#### Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa - Zyra e Tatimit në Pronë.

### Neni 3

#### Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në web faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me plotësim ndryshimet e bëre me Rregulloren nr.06/2021, dhe i njëjti zbatohet nga data 01 janar 2025.

Pejë, datë: 11.10.2024

**Diellëza Berisha**  
  
**Drejtorja për Buxhet dhe Financa**





REPUBLIKA E KOSOVËS      REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS      MUNICIPALITY OF PEJA  
OPSTINA PEC



|          |  |
|----------|--|
| PËR :    | <b>Z. Gazmend MUHAXHERI –Kryetar i komunes PEJË.</b><br><b>Z.Rexhep KURTBOGAJ –kryesueses i kuvendi komunal-PEJË</b>             |
| PËRMES : | <b>Z y r t a r i s h t</b>   |
| NGA:     | <b>Z. Nasret HAJRIZI- Drejtor për zhvillim ekonomik</b><br><b>Komuna . Pejë</b>  |
| LËNDA :  | <b>Propozim për faljen e borgjeve në taksa afariste për të gjitha bizneset që operojnë dhe kanë operuarë në Komunën e Pejës.</b> |
| DATE:    | <b>09.10.2024</b>  |

#### ARSYETIM.


I Nderuari kryetar , siq jeni ne dijeni në vitin 2002 ka filluare që të aplikohet taksa mbi ushtrimin e veprimtarisë afariste në komunën e Pejës.

Gjate kesajë periudhe sipas rregullores në fuqi në atë kohë bizneset që kan operuarë dhe operojnë në komunën e Pejes janë ngarkuare me tarifa të ndryshme sipas veprimtarisë .

Mirëpo ne vitin 2012 kryetari i komunës në ate periudhë ka nxjerr vendim (l.nr 400-8862/2012 ) që keto biznese që nga viti 2013 të mos aplikohet kjo taksë.

Ne baze të evidences financiare borgji i pergjithshem kapë shifren 6,391,030.00 euro dhe numri i pergjithshem i ketyrë bizneseve që kanë ngarkesë të tillë është 6540 biznese.

Andaj duke e pasure parasyshe se ky borgj është i pa inkasushem pasi kaluarë qdo afat i inkasimit të këtijë borgji , propozoj që të inicohet procedura e faljes se ketyre obligimeve permes kuvendi komunal.





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E PEJËS  
OPŠTINA PEC/MUNICIPALITY OF PEJA



ZYRA E KRYETARIT  
KANCELARIJA PRESEDNIKA/MAYOR'S OFFICE

**PËR:**

Zyra Kombëtare e Auditimit

**NGA:**

Gazmend Muhaxheri

Kryetar i Komunës së Pejës

**LËNDA:**

Raport periodik për zbatimin e rekomendimeve të Komiteteve Kombëtare të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës për Vitin 2023



Pejë  
Shtator 2024

| Nr. | Gjetja/Çështja  | Rekomandimi   | Vaprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin e rekomandimit  | Statusi i rekomandimit (i zbatuar pjesërisht, i zbatuar ose i pa zbatuar) | Sfdat e bazuara në zbatimin e rekomandimeve | Dëshmi/Provë |
|-----|---|---|--|---|---|--------------|
| 1   | Çështja A1. Inicimi i procedurave të prokurimit pa fonde të mjaftueshme         | Kryetari duhet të forcojë kontrollin gjatë vlerësimit të projekteve që para inicimit të procedurave të prokurimit për cado projekt kapital të ketë fonde të mjaftueshme për realizimin e projekteve.  | Inicimi i procedurave të jetë në harmoni me rregullat në fuqi  | Pjesërisht zbatuar  |   |              |
| 2   | Çështja A2. Zotimi i mjeteve dhe urdhër blerjeve jo sipas rregullave financiare | Kryetari duhet të sigurojë që respektohet hapat e përcaktuara me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave që gjatë procedimit të pagesave të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve pastaj të nxjerret urdhërblerja dhe në fund të pranohet puna shërbimi dhe të kryhet pagesa | Ka filluar që të respektohet Rregullrja nr.01/2013-MF për shpenzimin e parasë publike konkretisht nëni 22.   | Pjesërisht i zbatuar  |   |              |
| 3   | Çështja A3. Ndryshimet në shumën e ndara buxhetore në projektet ekzistuese      | Kryetari duhet të sigurojë që projektet e aprovuara të realizohen sipas planifikimit, nëse paraqitet nevoja për rëndësimin të fondeve të projekteve kjo të realizohet sipas procedurave të përcaktuara për rialokim në pajtim me ligjin për ndarjet buxhetore                         | Respektimi i ligjit nr.08/L-193 për ndarjet buxhetore për vitin 2023, si dhe respektimi i udhëzimit administrativ UA MF nr.05/2019 për procedurat e transferit dhe rialokimit të | Zbatuar   |   |              |



|   |   |   |  |                     |  |
|---|---|---|--|---------------------|--|
| 4 | <p>Çështja A.4. Mos përmbushja e kërkesës ligjore për inspektim të pronave të paluajtshme</p> | <p>Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20 % të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor</p>   | <p>Janë rekrutuar zyrtarët për evidentimin e pronave të paluajtshme dhe blerja e paisjeve përkatëse.</p>   | Zbatuar             |  |
| 5 | <p>Çështja A.5. Parregullsi në kontraktimin e qirasë/parkingjeve</p>                          | <p>Kryetari duhet të sigurojë që kontrollat e vendosura janë funksionale, kontratat të nënshkruhen para fillimit të periudhës së qirasë duke precizuar afatin e pagesës, periudhën kohore të rrjedhës së obligimeve kontraktuale si dhe të fillon të zbatohet me nënshkrimin e kontratës dhe propozimi për dhënjën në shfrytëzim të pronës duhet të identifikojë paraprakisht sipërfaqen e pronës së dhënë me qira.</p> | <p>Parkingjet janë dhënë në shfrytëzim afatshkurt për dhjetë (10) vite duke u mbështetur në një komision paraprak e që sipas vendpaskirjeve janë ndarë kontratat, ku ka qenë e pamundur të ndajmë në parcela pasi që shumica e paskirjeve janë të formuara në parcelat ku është rruga të evidentuara si rrugë, e që pjesët e tyre të</p> | Pjesërisht zbatuar, |  |

|  |  |  |  |  |
|--|--|--|--|--|
|  |  |  |  | <p>përshatshme janë formuar vëndpërkisje.</p> <p>Palët i kanë kryer obligimet gjashmujore dhe të njëjtit i kanë tërhoqur fakturat për gjasthtë (6) mujorin e dytë por nuk kanë aritur t'i paguajnë me kohë.</p> <p>Nga Drejtoria për Çështje Pronësore- Juridike janë njoftuar mbikqyrësit e kontratave dhe të njëjtit e kanë obligim që t'i mbikqyrin dhe të na njoftojnë për mbarëvajtjen e kontratave sipas kushteve të specifikuara.</p> <p>Vërejtjet janë marrë për bazë dhe po punohet që të mos</p> |
|--|--|--|--|--|

|   |  |   |  |                      |  |
|---|--|---|--|----------------------|--|
| 6 | Çështja B1. Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve           | Kryetari duhet të sigurojë që shpenzimet të planifikohen në ndarje adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestimi i mjeteve dhe që pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël.         | Shpenzimet në kuader të kategorive ekonomike perkatese do të behen konform Rregullores Financiare 01/2013                | Pazbatuar            | Planifikimi dhe shpenzimi në kuader të kategorive adekuate shpesh ndodhe shkak i kufizimit në planifikim, percaktimi i kufinjve në kategori ekonomike vjen nga Ministria e Financave poushtu ky keqklasifikim ka ndodhur për shkak të obligimeve nga Kontrata Kolektive. |
| 7 | Çështja B2. Vonesa në pagesën e faturave                   | Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare të kryhen në kohë brenda afatit prej 30 ditëve duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesën e faturave. | Ekzekutimi i pagesave të rregullta do të behet konform LMPPP-se. Dhe leshimi i një urdherese nga kryetari për drejtorit. | Pjesërisht e zbatuar | Krijimi i borxheve të reja në vazhdimësi si pasojë e vendimeve të Gjykatave që nuk janë në favor të komunës.   |
| 8 | Çështja B3. Vonesa në përfundimin e punëve të kontraktuara | Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontrollave në këtë fushë , një  | Do të vendosen kontrole strikte për mos  | Pjesërisht e zbatuar | Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore si pasoj  |

|   |   |  |  |  |
|---|---|--|--|--|
|   | <p>mbikqyrje rigorozë në menaxhimin e kontratave. Realizimi i kontratave të bëhet në përputhje me planin dinamik , afatit për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e paarsyetuara të aplikohen masat dhe ndëshkimet e parapara me kontratë.</p>            | <p>realizimin e punëve ku pritjet të ketë edhe masa ndëshkuese për moskryerjen e punëve/furnizimeve me kohë siq është parapare me kontratë.</p>              | <p>e kontratës kolektive ka afektuar edhe kategorit e investimeve kapitale ku ka prekur shumë projekte që kanë qenur në realizim dhe si pasoj ka shkaktuar vonesa në planin dinamik,</p> | <p>Plani vjetor i DKRS-së nr. 30068, i datës: 23.03.2023.<br/>2) Plani vjetor i DSHMS-së nr. 824, i datës: 09.06.2023.</p> |
| <p>9</p> <p>Çështja B4. Dobësitë në menaxhimin e subvencioneve</p>  | <p>Kryetari duhet të sigurojë se caktohen zyrat përgjegjës të cilët duhet kujdesen për monitorimin e implementimit të projekteve. Po ashtu të siguroj se OJQ të përfutuese të subvencioneve dorëzojnë raporte financiare dhe narrative</p>                          | <p>Kryetari duhet të sigurojë se do të ndërmerrin veprimet për hartimin e planit vjetor për mbështetjen e OJQ-ve.</p>  | <p>Pjesërisht e zbatuar</p>  |  |
| <p>10</p> <p>Çështja B5. Dobësi në menaxhimin e projekteve përmes platformës elektronike të E-Procurement</p> | <p>Kryetari duhet të rishikoj shkaqet e mos përdorimit të sistemit e-prokurimi dhe të ndërmarrë masa shitesë të kontrollit apo nevojave tjera, për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet në sistemin elektronik të prokurimit publik</p> | <p>Te gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratave do të përgaditen, mbahen si dhe menaxhohen përmes sistemit elektronik konform Udhëzuesit Operativ për</p> | <p>Tok kontratat e kapitaleve tujë shtidë të përdorimi i platformës elektronike mbete ngarkesa e madhe që kanë inxhinieret</p>   |  |

|    |   |  |   |                    |  |
|----|---|--|---|--------------------|--|
| 11 | <p>Çështja B6. Mos regjistrimi i pasurive dhe mos hartimi i një rregullore të brendshme për menaxhimin e pasurive jo financiare</p> | <p>Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës janë regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale, sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore</p>                          | <p>Prokurim Publik<br/>Rregullorja për menaxhin e pasurive-jo financiare është hartu dhe është në implementim</p>   | Pjesërisht zbatuar |  |
| 12 | <p>Çështja C1.Rritja e llogarive të arkëtueshme si pasoje e vonesave në arkëtimin e të hyrave</p>                                   | <p>Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Masat e parapara në kontratë, shkëputje të kontratës duhet të zbatohen me qëllim të vetëdijësimit dhe mirjes së përgjegjës së qiramarrësve/ obliguesve ndaj Komunës</p> | <p>1) <b>Është</b> shtuar kontrolli i brendshëm dhe angazhimi i stafit për përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme.<br/>2) <b>Është</b> publikuar thirrja publike për tatimpaguesit, përmes ëeb-faqes së komunës dhe rrjeteve sociale të Kryetarit, për shfrytëzimin e mundësisë së arritjes së marrëveshjes për pagesën e borxheve me këste.</p> | Pjesërisht zbatuar |  |



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

---

DREJTORATI PËR BUXHET E FINANCA

RAPORTI  
I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE TË REALIZUARA BUXHETORE PËR PERIUDHËN  
JANAR – SHTATOR TË VITIT 2024

PEJË , TETOR 2024

## PËRMBAJTJA :

| Përshkrimi   | Faqja  |
|--|--------|
| Përmbajtja   | 1      |
| Buxheti i realizuar komunal për periudhën Janar - Shtator 2024       | 2      |
| Të dhënat e punësimit  | 3      |
| Të hyrat vetanake të realizuara gjatë periudhës Janar - Shtator 2024 | 4 - 6  |
| Shpenzimet e realizuara buxhetore për periudhën Janar - Shtator 2024 | 7 - 20 |
| Zyra e Kryetarit   | 21     |
| Administrata dhe personeli   | 22     |
| Çështjet gjinore   | 23     |
| Integrimet Europiane   | 23     |
| Inspekcioni  | 24     |
| Prokurimi  | 25     |
| Asambleja Komunale   | 25     |
| Buxhet e financa   | 26     |
| Punë komunale , shërbime publike                                     | 27-28  |
| Emergjenca - zjarrfikësat  | 28     |
| Zyra komunale për komunitete dhe kthim                               | 29     |
| Bujqësi , pylltari , zhvillim rural                                  | 29-30  |
| Zhvillimi ekonomik   | 30-31  |
| Gjeodezi dhe kadastër  | 31-32  |
| Çështje pronësore - juridike   | 32     |
| Planifikimi urban dhe mjedisi  | 33     |
| Shëndetësia - Administrata   | 34     |
| Shëndetësia - Kujdesi primar shëndetsor                              | 34-35  |
| Shëndetësia - Shërbime sociale                                       | 35     |
| Shërbimet kulturore  | 35-36  |
| Teatri   | 36     |
| Arsimi - Administrata  | 37     |
| Arsimi - Arsimi parashkollor - Çerdhet                               | 37-38  |
| Arsimi - Arsimi fillor   | 38     |
| Arsimi - Arsimi i mesëm  | 39     |

## **BUXHETI I REALIZUAR KOMUNAL PËR PERIUDHËN JANAR - SHTATOR TË VITIT 2024**

Duke u bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë (Nr. 03/L-048) i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-221 , Ligjin Nr.04/L-116 , Ligjin Nr.04/L-194 , Ligjin Nr.05/L-063 dhe me Ligjin Nr.05/L-007 Drejtorati për buxhet e financa është i obliguar t'i dorëzoj raportet tremujore dhe raportin vjetor të buxhetit për vitin fiskal .

Raporti ka për qëllim informimin sa më objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përbushjes së planit dhe grumbullimit të mjeteve sipas burimeve,përbushjes së obligimeve të planifikuara sipas planprogrameve,dinamikën dhe strukturë mjeteve të planifikuara si dhe realizimin e tyre sipas kategorive të përcaktuara buxhetore,angazhimet kadrovike si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë .

Ecuria e të hyrave të arketuara dhe shpenzimeve të realizuara gjatë periudhës Janar-Shtator të vitit 2024 është e prezentuar tek të gjitha programet në raport me planin vjetor dhe realizimin gjatë periudhës së njëjtë të vitit paraprak .



## TË DHËNAT E PUNËSIMIT

Sipas Ligjit Nr. 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për Republikën e Kosovës për vitin 2024 Komuna e Pejës ka planifikuar të punësojë 2211 puntorë . Ky plan gjatë periudhës Janar - Shtator të vitit raportues është realizuar 99.68 % , ndërsa dinamika e të punësuarve në raport me periudhën krahasuese është më lartë për 0.59 % . Në fund të periudhës raportuese numri i të punësuarve është 2204

| Kodi i programit | Emërtimi i kodit                               | Numri aktual<br>I - IX - 2023 | Planifikimi<br>I - XII - 2024 | Numri aktual<br>I - IX - 2024 | Progresi :     |               | %              |
|------------------|--|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|----------------|---------------|----------------|
|                  |  |                               |                               |                               | 5 / 3          | 5 / 4         |                |
| 1                | 2  | 3                             | 4                             | 5                             | 6              | 7             | 8              |
| 16019            | <b>Zyra e Kryetarit</b>                        | 15                            | 20                            | 20                            | 133.33%        | 100.00%       | 0.91%          |
| 163              | <b>( I+II+III ) Administrata dhe personeli</b> | 55                            | 61                            | 57                            | 103.64%        | 93.44%        | 2.59%          |
| 16319            | I. Administrata                                | 54                            | 59                            | 55                            | 101.85%        | 93.22%        | 96.49%         |
| 16519            | II. Çështjet gjinore                           | 0                             | 1                             | 1                             | #DIV/0!        | 100.00%       | 1.75%          |
| 16559            | III. Integrimet europiane                      | 1                             | 1                             | 1                             | 100.00%        | 100.00%       | 1.75%          |
| 16637            | <b>Inspeksioni</b>                             | 23                            | 27                            | 23                            | 100.00%        | 85.19%        | 1.04%          |
| 16795            | <b>Prokurimi</b>                               | 3                             | 4                             | 4                             | 133.33%        | 100.00%       | 0.18%          |
| 16919            | <b>Asambleja komunale</b>                      | 70                            | 35                            | 66                            | 94.29%         | 188.57%       | 2.99%          |
| 17519            | <b>Buxhet e financa</b>                        | 25                            | 33                            | 32                            | 128.00%        | 96.97%        | 1.45%          |
| 180              | <b>(I+II) Punë komunale,shërbime publike</b>   | 48                            | 55                            | 53                            | 110.42%        | 96.36%        | 2.40%          |
| 18019            | I. Infrastruktura rrugore                      | 12                            | 14                            | 13                            | 108.33%        | 92.86%        | 24.53%         |
| 18295            | II. Emergjenca - zjarrëfikësat                 | 36                            | 41                            | 40                            | 111.11%        | 97.56%        | 75.47%         |
| 19595            | <b>Zyra lokale e komuniteteve</b>              | 7                             | 8                             | 7                             | 100.00%        | 87.50%        | 0.32%          |
| 47019            | <b>Bujqësi , pylltari , zhvillim rural</b>     | 23                            | 25                            | 21                            | 91.30%         | 84.00%        | 0.95%          |
| 48019            | <b>Zhvillim ekonomik</b>                       | 6                             | 6                             | 6                             | 100.00%        | 100.00%       | 0.27%          |
| 650              | <b>( I+II ) Gjeodezi dhe kadastër</b>          | 22                            | 23                            | 23                            | 104.55%        | 100.00%       | 1.04%          |
| 65095            | I. Shërbime kadastrale                         | 17                            | 18                            | 18                            | 105.88%        | 100.00%       | 78.26%         |
| 65495            | II. Çështje pronësore - juridike               | 5                             | 5                             | 5                             | 100.00%        | 100.00%       | 21.74%         |
| 66100            | <b>Planifikimi urban dhe mjedisi</b>           | 13                            | 12                            | 11                            | 84.62%         | 91.67%        | 0.50%          |
| 730              | <b>Shëndetësia</b>                             | 340                           | 358                           | 342                           | 100.59%        | 95.53%        | 15.52%         |
| 73028            | - Administrata                                 | 4                             | 4                             | 4                             | 100.00%        | 100.00%       | 1.17%          |
| 74100            | - Kujdesi primar shëndetsor                    | 336                           | 354                           | 338                           | 100.60%        | 95.48%        | 98.83%         |
| 75590            | <b>Shërbimet Sociale</b>                       | 18                            | 30                            | 18                            | 100.00%        | 60.00%        | 0.82%          |
